



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

V E N D I M

Nr. 30, datë 02.06.2016

**“Mbi vlerësimin e dëmeve nga ana ndërtimore dhe e dëmeve në orendi të familjes së
Z.Gjergj Hila, banor i fshatit Plezhë”**

Bashkia Vau i Dejës pas shqyrtimit të procesverbalin nr.585 date 09.11.2015 “Per konstatim të dëmeve të shkaktuara në banesën e djegur” të Komisionit të Verifikimit të Dëmeve (bashkëngjitur), Shkresën “Vlerësimi i orendive, mobiljeve dhe paisjeve elektroshtëpiake” të Komisionit të ekspertëve të Këshillit të Qarkut Shkoder (bashkëngjitur); Preventivit për “Vlerësimi i dëmeve nga ana ndërtimore”, të hartuar nga Këshilli i Qarkut Shkoder (bashkëngjitur).

Bazueshmeria ligjore: ligjit Nr.139/2015, “Per vetqeverisjen vendore”; Ligjin nr.8756 datë 26.03.2001 “Për emergjenat civile” i ndryshuar; Vendimit të Keshillit të Ministrave nr.329, date 16.05.2012 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare, per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore”, Udhezimi i perbashket Ministrise se Brendshme dhe Ministrise se Financave nr.263 date 24.05.2013 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare, per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore” ; Udhezimit nr.4 date 30.09.2015 të KM “Per miratimin e koston mesatare te ndertimit te banesave nga Enti Kombetar i Banesave per vitin 2015, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejes për të përballuar dëmet e shkaktuara nga djegia e shtëpisë e ndodhur me datë 08.11.2015 në familjen e z.Gjergj Hila ne fshatin Plezhë, Bashkia Vau i Dejës të përbërë me 5 anëtar, Keshillit i Bashkisë në mbledhjen e datës 02/06/2016, më shumicë të cilësuar votash:

VENDOSI:

1. Vlera e dëmit nga ana ndërtimore është në shumën 483768.2 (katër qind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë dy) leke sipas preventivit të hartuar nga specialistët e Këshillit të Qarkut “Preventiv për vlerësimin e dëmeve nga ana ndërtimore” dhe të miratuara nga Këshilli i Qarkut Shkoder.
2. Vlera e dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është në shumën 612,000 (gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë) leke, sipas shkresës “Vlerësimi i orendive, mobiljeve dhe paisjeve elektroshtëpiake” të Komisionit të ekspertëve të Këshillit të Qarkut Shkoder
3. Ti popozojë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhënien e diferencës midis ndihmës financiare të dhënë nga Këshilli i Bashkisë Vau i Dejës me vendimin nr.52, datë 27/11/2015 në vlerën 7000

lekë (bashkëngjitur) dhe dëmeve të konstatuara nga ana ndërtimore dhe dëmeve në orëndi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake.


4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Financës.

5. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga Buxheti i vitit 2016.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore".

6. U shpall sot me datë 10/06/2016.

SEKRETARI
Gentian NDOJ



KRYETARI
Martin MARKU

